



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VI**

**R A P O R T**  
**FUNDMANDATOR**

**2017 - 2019**

**I PUNËS SË KOMISIONIT PARLAMENTAR PËR ZHVILLIM EKONOMIK,  
INFRASTRUKTURË, TREGTI, INDUSTRI DHE ZHVILLIM RAJONAL**

---

**Gusht 2019**

# **Përmbajtja**

## **Përbërja dhe struktura e Komisionit**

### **I. Hyrje**

### **II. Fushëveprimi i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal**

### **III. Aktivitetet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal**

- a. Mbledhjet e Komisionit**
- b. Shqyrtimi i projektligjeve**
- c. Projektligjet e trajtuara nga Gjykata Kushtetuese**
- d. Nisma legjislative**
- e. Shqyrtimi i raporteve vjetore për punën e institucioneve të pavarura**
- f. Shqyrtimi i propozimeve dhe raporteve të institucioneve, si dhe kërkesave të palëve**
- g. Mbikëqyrja parlamentare**
- h. Dëgjimet publike**
- i. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve**
- j. Aktivitete të tjera në kuadër të fushëveprimit të Komisionit**
- k. Vizitat pune brenda vendit**
- l. Vizita pune jashtë vendit**
- m. Takimet e Komisionit**
- n. Tryeza/Punëtori të organizuara**
- o. Bashkëpunimi ndërparlamentar**
- p. Buxheti i Komisionit**

### **IV. Rezume e punës së Komisionit (tabela)**

### **V. Vlerësimi i Komisionit**

***Përbërja dhe struktura e Komisionit<sup>1</sup>***

<b>Nr. rendor</b>	<b>Emri dhe mbiemri</b>	<b>Pozita</b>	<b>Përkatësia politike</b>
<b>1</b>	Sala BERISHA - SHALA	kryetare	G/P – PDK
<b>2</b>	Dardan SEJDIU <sup>2</sup>	zëvendëskryetar i parë	G/P – PSD
<b>3</b>	Adem Hoxha	zëvendëskryetar i dytë	G/P – LS
<b>4</b>	Liburn ALIU <sup>3</sup>	anëtar	G/P – LVV
<b>5</b>	Glauk KONJUFCA <sup>4</sup>	anëtar	G/P – LVV
<b>6</b>	Hykmete BAJRAMI	anëtare	G/P – LDK
<b>7</b>	Lutfi ZHARKU <sup>5</sup>	anëtar	G/P – LDK
<b>8</b>	Memli KRASNIQI	anëtar	G/P – PDK
<b>9</b>	Muharrem NITAJ <sup>6</sup>	anëtar	G/P – AAK
<b>10</b>	Veton BERISHA <sup>7</sup>	anëtar	G/P – NISMA
<b>11</b>	Duda BALJE	anëtare	G/P – 6+

<sup>1</sup> Në Legjislaturën VI 2017-2019, në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal anëtarët e tij janë ndërruar në grupet parlamentare VV, AAK dhe NISMA më të dhënat e paraqitura në tabelë.

<sup>2</sup> Sipas vendimit të Kuvendit të Kosovës nr.06-V-166 datë 14.6.2018, për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.06-V-006, të datës 3 tetor 2017 për përbërjen e Komisioneve.

<sup>3</sup> Sipas vendimit të Kuvendit të Kosovës nr.06-V-166, datë 14.6.2018, për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.06-V-006, të datës 3 tetor 2017, për përbërjen e Komisioneve.

<sup>4</sup> Sipas vendimit të Kuvendit të Kosovës nr.06-V-166, datë 14.6.2018, për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.06-V-006, të datës 3 tetor 2017, për përbërjen e Komisioneve.

<sup>5</sup> Sipas vendimit të Kuvendit të Kosovës nr.06-V-253, datë 2.11.2018, deputeten Mimoza Kusari Lila e ka zëvendësuar deputeti Lutfi Zharku nga GP LDK.

<sup>6</sup> Sipas vendimit të Kuvendit të Kosovës nr.06-V-180, datë 12.7.2018, deputetin Gani Dreshaj e ka zëvendësuar deputeti Muharrem Nitaj nga GP AAK.

<sup>7</sup> Sipas vendimit të Kuvendit të Kosovës nr.06-V-221, datë 15.10.2018, deputetin Bilall Sherifi e ka zëvendësuar deputeti Veton Berisha nga GP NISMA.

## **I. Hyrje**

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal (në tekstin në vijim: Komisioni), është Komision FunkSIONAL i Kuvendit të Republikës së Kosovës<sup>8</sup>. Qëllimi i tij është t'i shqyrtojë të gjitha çështjet, që kanë të bëjnë me ekonominë, infrastrukturën, tregtinë, industrinë, energjetikën, transportin, telekomunikacionin etj.

Më qëllim të pasqyrimin të punës së tij në Legjislaturën VI, Komisioni e ka hartuar Raportin Fundmandator, i cili përmban të dhëna, informacione dhe shënime, që tregojnë për aktivitetet dhe për punët që i ka realizuar gjatë periudhës 2017 - 2019, në pajtim me detyrat dhe me përgjegjësitë që i ka të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në bazë të marrëveshjes së grupeve parlamentare, Komisioni ka qenë i përbërë me anëtarë nga të gjitha grupet parlamentare (Shih për këtë tabelën me përbërjen dhe me strukturën e Komisionit).

---

<sup>8</sup> Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 69 par. 4.3.

## **II. Fushëveprimi i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal**

Komisioni në kuadër të fushëveprimit dhe të përgjegjësiave i shqyrton të gjitha çështjet që përfshijnë:

- Shqyrtimin e projektligjeve të fushëveprimit të tij;
- Shqyrtimin e strategjisë së përgjithshme për zhvillimin e veprimtarive ekonomike të Kosovës, duke i bërë rekomandime Kuvendit dhe ministrisë përkatëse etj.;
- Krijimin e infrastrukturës ligjore për mjedis më të sigurt për investime, për marrëveshje tregtare, për koncesione në infrastrukturë, energjetikë, resurse minerale dhe që lidhen me zhvillimin e këtyre degëve ekonomike;
- Angazhimin dhe përcjelljen e zbatimit të politikave të përgjithshme në fushën e ekonomisë, të tregtisë, të industrisë, dhe të transportit;
- Shqyrtimin e projektbuxhetit dhe rishikimin e buxhetit të ministrive dhe agjencive rregullatore që i raportojnë Komisionit, dhe i rekomandon Komisionit për Buxhet, shqyrtimin dhe miratimin e tij në Kuvend, duke i përfshirë edhe amendamentet;
- Mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe agjencive rregullatore të fushëveprimit të tij;
- Shqyrtimin e çështjeve të tjera të përcaktuara me Rregullore dhe të çështjeve, të cilat me vendim të veçantë të Kuvendit i barten këtij Komisioni;

Në ushtrimin e funksioneve, Komisioni bashkëpunon me ministrinë e resorit përkatës dhe me të gjitha ministrinë e tjera, nga të cilat mund të kërkojë të dhëna konkrete, i duke përfshirë këtu edhe raportet e drejtpërdrejta të ministrave ose të personave të tjerë përgjegjës, kur kjo kërkohet nga Komisioni.

Komisioni parlamentar për të marrë informacione shtesë nga grupet e interesit apo aktoret kryesorë për zbatimin e ligjit dhe mbikëqyrjes efektive të politikave në bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile organizon dëgjime publike dhe tryeza të rrumbullakëta ku diskutohet legjislacioni në interes të zhvillimit ekonomik dhe mënyrat për të nxitur biznesin dhe prodhimin vendas në Kosovë, përmirësimi i mjedisit biznesor, dhe tryezën për funksionimin dhe fuqizimin e Agjencive dhe Rregullatorëve që i raportojnë Komisionit.

## **III. Aktivitetet e Komisionit**

Komisioni gjatë Legjislaturës VI ka zhvilluar aktivitetet e tij në bazë të Planeve të tij Vjetore të Punës të hartuara gjithnjë duke u bazuar në Strategjitë legjislative të Qeverisë<sup>9</sup>. Këto aktivitete Komisioni i ka realizuar nëpërmjet mbledhjeve të rregullta, nëpërmjet mbledhjeve të grupeve të punës, dëgjimeve publike, monitorimit të zbatimit të ligjeve, takimeve zyrtare brenda dhe jashtë vendit dhe nëpërmjet vizitave zyrtare në institucionet

---

<sup>9</sup> Komisionet parlamentare në secilin fillim vit pasi ta marrin Strategjinë legjislative nga Qeveria e hartojnë Planin e Punës për vitin vijues.

përkatëse më qëllim të mbikëqyrjes së punës së tyre, si dhe nëpërmjet vizitave të bizneseve.

Objektiv i përgjithshëm i Komisionit ishte nxitja e aktiviteteve në rrafshin institucional në kompletimin dhe përmirësimin e kornizës ligjore, zbatimin e ligjit dhe inicimin e masave dhe politikave; monitorimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve qeverisëse dhe rregullatorëve të pavarur për të përmirësuar mjedisin biznesor, nxitjen e investimeve të huaja, rritjen ekonomike dhe përsosjen e aseteve të Ndërmarrjeve Publike në interesin më të mirë publik.

Duke u bazuar në Strategjitë legjislative të Qeverisë Komisioni në fillim të viteve 2017, 2018 dhe 2019, e ka miratuar Planin e Punës, në bazë të cilit edhe i ka zhvilluar aktivitetet e veta.

Plani i Punës ka paraparë që Komisioni, gjatë viteve të përmendura më lart, të angazhohet:

- në ndërtimin e infrastrukturës ligjore nën juridiksionin e tij;
- të grumbullojë informata nëpërmjet dëgjimeve publike dhe formave të tjera të komunikimit dhe të bashkëpunimit me qëllim të miratimit të ligjeve sa më cilësore;
- ta monitorojë zbatimin e ligjeve (së paku një ligj brenda vitit kalendarik);
- të monitorojë punën e institucioneve të pavarura nga fushëveprimin i Komisionit;
- të trajtojë tema aktuale nga fushat e ndërmarrjeve publike dhe nga fushat e tjera përkatëse që i përcjell Komisioni;
- të bashkëpunojë ngushtë me institucionet e Kosovës dhe me përfaqësitë e organizatave ndërkombëtare;
- të angazhohet në ngritjen e cilësisë së punës dhe të bashkëpunimit të brendshëm, duke e përfshirë edhe stafin mbështetës të tij, me qëllim të përmirësimit në vazhdimësi të formave dhe të metodave të punës së Komisionit në fushën e komunikimit dhe të bashkëpunimit me OJQ-të dhe me qytetarë.

#### **a) Mbledhjet e Komisionit**

Komisioni gjatë Legjislaturës VI i ka realizuar gjithsej 72 (shtatëdhjetë e dy) mbledhje të rregullta. *Mbledhjen e tij të parë e ka mbajtur më 10.10.2017*, që është aktiviteti i parë i tij dhe fillimi i funksionimit të tij, si Komisioni FunkSIONAL i Kuvendit të Kosovës. *Ndërkaq mbledhja e fundit e Komisionit është mbajtur më 23.7.2019*, që është aktiviteti i fundit i Komisionit për Legjislaturën VI.

Gjatë punës së vet, Komisioni, ka zbatuar procedurat e parapara me Rregulloren e Kuvendit<sup>10</sup>. Gjithnjë në mbështetje të Rregullores së Kuvendit, Komisioni i ka realizuar mbledhjet dhe takimet e tij të rregullta, në të cilat janë shqyrtuar treqind e pesëmbëdhjetë

---

<sup>10</sup> Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 62.

(315) pika të rendit të ditës<sup>11</sup>.

Në mbledhjet e Komisionit, sipas ftesës, kanë marrë pjesë përfaqësues të ministrive (ministra, zëvendësministra, etj.) dhe përfaqësues të organizatave të tjera.

Mbledhjet e Komisionit kanë qenë publike, përveç kur Komisioni ka vendosur ndryshe dhe janë mbikëqyrur nga përfaqësues të organizatave qeveritare dhe joqeveritare vendore e ndërkombëtare<sup>12</sup>. Punën e Komisionit e kanë vëzhguar përfaqësuesit e INDEP-it, KDI-së, NDI-së, D+it, KPK, asociacione dhe organizata të tjera. Po ashtu puna e Komisionit ka pasur hapësirë të mjaftueshme edhe në media të shkruara dhe në ato elektronike.

Në realizimin e punës së vet, Komisioni është mbështetur nga partnerë dhe ekspertë të ndryshëm. *Komisioni shprehë falënderim të posaçëm për Institutin INDEP, D+-in dhe NDI-në* që ka ndihmuar Komisionin me analizë të pavarur hulumtuese dhe po ashtu për ndihmën e dhënë në organizimin e aktiviteteve si tryeza, etj.

Duke i marrë parasysh aktivitetet e zhvilluara gjatë kësaj Legjislature, Komisioni ka arritur në masën më të madhe të përmbush Planin e Punës për vitet përkatëse të Legjislaturës VI.

### **b) Shqyrtimi i Projektligjeve**

Gjithnjë në frymën e dispozitave kushtetuese, Kuvendi i Republikës së Kosovës përfaqëson pushtetin ligjvënës<sup>13</sup>. Komisioni si organ i Kuvendit, duke zbatuar mandatin e tij, miratimin e ligjeve apo ligj bërjen, gjatë Legjislaturës së VI, ka shqyrtuar dhe miratuar Projektligjet në kuadër të fushëveprimit e tij.

Gjatë kësaj Legjislature, Komisioni ka arritur që falë angazhimit të tij ta bëjë të mundur *shqyrtimin e 22 (njëzetë e dy) Projektligjeve* dhe një Projektstatuti, ku prej tyre janë miratuar nga Kuvendi gjithsej 19 (nëntëmbëdhjetë) projektligje<sup>14</sup>; 1 (një) projektstatut, ndërsa 3 (tri) projektligje edhe pse janë proceduar për lexim të dytë kanë mbetur në procedurë për shkak të shpërbërjes së Kuvendit.

Projektligjet e miratuara janë si vijon:

1. Projektligji për Standardizim, 26.1.2018;
2. Projektligji për Shoqëritë Tregtare, 16.5.2018<sup>15</sup>;
3. Projektligji për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, 30.3.2018;
4. Projektligji për Pajisjet nën presion, 30.3.2018;

---

<sup>11</sup> Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 64.

<sup>12</sup> Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 65.

<sup>13</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 63 dhe 65

<sup>14</sup> Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 62.

<sup>15</sup> Data a miratimit pas kthimit nga Presidenti i Republikës, sepse Kuvendi e pati miratuar në lexim të dytë, më 15.3.2018;

5. Projektligji për Metrologji, 30.3.2018;
6. Projektligji për Kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit, 30.3.2018;
7. Projektligji për mbrojtjen e konsumatorit, 17.5.2018;
8. Projektligji për masat mbrojtëse në importe, 12.7.2018;
9. Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit “Konkurrenca e Ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (COSME) (2014-2020), 23.7.2018.
10. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-064 për Patentë Shoferi, 14.9.2018;
11. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/11 për rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-0120, 14.9.2018;
12. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, 14.9.2018;
13. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-179 për Transportin rrugor, 14.9.2018;
14. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-183 për Transportin tokësor të mallrave të rrezikshme, 14.9.2018;
15. Projektligji për Produkte të ndërtimit, 7.11.2018;
16. Projektligji për Eficiencën e Energjisë, 7.11.2018;
17. Projektligji për Ratifikimin e Traktatit që themelon Komunitetin e Transportit, 25.10.2018;
18. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, 21.12.2018;
19. Projektligji për shërbimet postare, 21.12.2018.

Projekt akte tjera të miratuara:

1. Projektstatuti i Trepçës, 03.2.2019.

Projektligjet që për shkak të shpërndarjes së Kuvendit, më 22 gusht 2019, kanë mbetur të pa miratuar, edhe pse ishin proceduar për lexim të dytë, janë si në vijim:

1. Projektligji për miniera dhe minerale;
2. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Automjete;
3. Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Protokolin shtesë 5 të Marrëveshjes për Amendimin dhe Aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore.

Nuk ka projektligje të cilat Kuvendi ia ka kthyer Qeverisë ose janë tërhequr nga Qeveria.



Në lidhje më shqyrtimin e projektligjeve të lartcekura *Komisioni ka formuar 17 (shtatëmbëdhjetë) grupe punuese* për secilin Projektligj, apo pako projektligjesh nga një Grup punues. *Numri i mbledhjeve të grupeve punuese është 40 (katërdhjetë)*. Në Grupe punuese janë trajtuar Projektligjet nga aspekti profesional dhe teknik, ku për të cilat kryesuesi i Grupit punues ka ftuar ministrinë e linjës, ekspert të ndryshëm që kanë marrë pjesë në hartimin e Projektligjit, si dhe ka marrë opinionet e ekspertëve të angazhuar në Komision.

Gjatë shqyrtimit të këtyre Projektligjeve, *Komisioni ka hartuar dhe miratuar 349 (treqind e katërdhjetë e nëntë) amendamente*.

### **c) Projektligjet e trajtuara nga Gjykata Kushtetuese**

Gjatë kësaj legjislature nuk ka pasur asnjë projektligj të miratuar i cili është dërguar për vlerësim të kushtetutshmërisë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës<sup>16</sup>.

### **d) Nisma Legjislative**

Njëkohësisht, Komisioni ka marrë nisma edhe të hartimit të Projektligjeve dhe gjatë kësaj Legjislature e ka hartuar 1 (një) projektligj<sup>17</sup>;

Komisioni më 24.10.2017 me propozimin e deputetes Sala Berisha – Shala, ka marrë nismë legjislative për hartimin e Projektligjit për Miniera dhe Minerale<sup>18</sup>. Grupi punues ka bashkëpunuar ngushtë dhe është koordinuar më Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, si dhe me ministritë përkatëse në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe ekspertë të fushës, si dhe me Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale – KPMM. Komisioni, më 30.11.2017, e ka përfunduar punën e tij dhe e ka proceduar për mendim në Qeveri sipas procedurës. Qeveria ka dhënë mendimin e saj dhe projektligji sipas procedurave është shqyrtuar dhe miratuar në Komision dhe është proceduar për lexim të dytë në seancë plenare. Për shkak të shpërndarjes së Kuvendit më 22.08.2019, projektligji nuk është miratuar në Kuvend.

### **e) Shqyrtimi i Raporteve vjetore për punën e institucioneve të pavarura**

Komisioni në bazë të fushëveprimit të tij gjatë kësaj Legjislature i ka shqyrtuar edhe raportet vjetore të institucioneve të pavarura, të themeluara nga Kuvendi<sup>19</sup>. Komisioni

---

<sup>16</sup> Në bazë të nenit 113.5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, 10 (dhjetë) a më shumë deputetë të Kuvendit, brenda një afati prej 8 (tetë) ditësh nga dita e miratimit të një Ligji, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo Ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur;

<sup>17</sup> Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 53.

<sup>18</sup> Kjo nismë legjislative është e kryetares Sala Berisha – Shala në mbështetje të komisionit.

<sup>19</sup> Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 72.

lidhur me këto raporte ka hartuar Raport me Rekomandime, të cilat ishin temë diskutimi në mbledhje plenare të Kuvendit të Kosovës.

Raportet vjetore të punës së institucioneve të pavarura janë shqyrtuar nga ana e Komisionit, si vijon:

1. Raporti vjetor i punës së Zyrës së Rregullatorit për Energji (për vitin 2017 dhe 2018);
2. Raporti vjetor i punës së Autoritetit të Aviacionit Civil (për vitin 2017 dhe 2016);
3. Raporti vjetor i punës së Autoritetit Kosovar të Konkurrencës (për vitin 2017 dhe 2018);
4. Raporti vjetor i punës së Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (për vitin 2017 dhe 2018);
5. Raporti vjetor i punës së Autoritetit Rregullativ Hekurudhor (për vitin 2017 dhe 2018);
6. Raporti vjetor i punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit (për vitin 2017 dhe 2018);
7. Raporti vjetor i punës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (për vitin 2016 dhe 2017);
8. Raporti vjetor i punës së Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (për vitin 2016, 2017 dhe 2018).

Raporti vjetor i punës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut për vitin 2018 edhe pse institucion në fjalë e ka dorëzuar me kohë, nuk është shqyrtuar nga ana e Komisionit, për shkak të mungesës së bordit në këtë institucion.

Për shkak të shpërndarjes së Kuvendit, raportet vjetore për vitin 2018 të institucioneve të pavarura nuk janë shqyrtuar në Kuvend.

#### **f) Shqyrtimi i propozimeve dhe raporteve të institucioneve, si dhe i kërkesave të palëve**

Komisioni i ka shqyrtuar edhe propozimet e Qeverisë për emërime të anëtarëve në bordet dhe komisionet e institucioneve të pavarura përkatëse që janë proceduar për miratim në Kuvend, siç janë: ZRRE dhe AKP.

Po ashtu Komisioni ka bërë përzgjedhjen e kandidateve për anëtar të Bordit të KOSTT-it dhe e ka proceduar për seancë plenare. Procesin e intervistimit e ka mbështetur Projekti i Ambasadës Britanike BDO.

Gjatë kësaj legjislature Komisioni shqyrtoi vendimet dhe raportet e Qeverisë, kërkesa të institucioneve publike dhe private dhe të gjitha i adresoi në bazë të Rregullores së Kuvendit, si në vijim:

- Shqyrtimi i Raportit të Performancës së Ndërmarrjeve Publike për vitin 2015, 2016 dhe 2017, të propozuar nga Qeveria;

- Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë nr.07/21, datë 22.12.2017 për Ndërmarrjen “Qendra Shoqërore, Sportive, Kulturore dhe Ekonomike- Pallati i Rinisë – PRN067, të propozuar nga Qeveria;
- Shqyrtimi i kërkesës së ARKEP për shkarkimin e një anëtari të bordit të ARKEP;
- Shqyrtimi i kërkesës së Fabrikës së ujit KIKA;
- Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë nr.05/85 datë 22.1.2019 me të cilin autorizohet Komisioni Qeveritar për Privatizimin e Ndërmarrjes Publike “Telekomi i Kosovës” SH.A.- ka mbetur në proces të shqyrtimit në Komision;
- Shqyrtimi i kërkesës së Odës Ekonomike të Kosovës dhe Odës Ekonomike Amerikane lidhur me shqetësimin për furnizim me energji elektrike për biznese;
- Shqyrtimi i kërkesës së menaxhmentit të NP KOSTT lidhur me ligjin për pagat.

### **g) Mbikëqyrja parlamentare**

Duke ushtruar mandatin e tij si mbikëqyrës i punës së Qeverisë/Ministrive që i raportojnë Komisionit, ministrat e dikastereve përkatëse janë ftuar për raportim në seanca dëgjimore në Komision varësisht nga tema të cilën e ka trajtuar Komisioni.

Me poshtë kemi listën e raportimeve të Ministrave në Komision gjatë Legjislaturës VI, më sa vijon:

1. Raportim i z. Bajram Hasani, ministër i Tregtisë dhe Industrisë, në mbledhje të komisionit, më 7.11.2017, lidhur me përparësitë e ministrisë, si dhe shqyrtimin në parim të Projektligjit nr.06/L-016 për Shoqëritë tregtare dhe Projektligjit nr.06/L-019 për Standardizim;
2. Raportim i z. Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik, në mbledhje të komisionit, më 22.12.2017 lidhur me prioritetet e ministrisë, si dhe për Strategjinë e Energjisë 2017-2026.
3. Raportim i z.Pal Lekaj, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës, në mbledhje të Komisionit më 23.1.2018, lidhur me pretendimet e Bechtel – Enka, për penalet që kanë derivuar nga mospërmbushja e detyrimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në ndërtimin e Autostradës “Arben Xhaferi”;
4. Raportim i z. Xhavit Zariqi, zëvendësministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, në mbledhje të Komisionit më 30.1.2018, lidhur me Projektligjin nr.06/L-027 për Miniera dhe Minerale, Projektligjin nr.06/L-031 për Pajisjet nën Presion, dhe Projektligjin nr.06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës;
5. Raportim i z.Bajram Hasani, ministër i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në mbledhje të Komisionit më 7.2.2018, lidhur me shqyrtimin në parim të Projektligjit nr.06/L-033 për Produkte të Ndërtimit; Projektligjit nr.06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Projektligjit nr.06/L-040 për Masat Mbrojtëse në Importe;
6. Raportim i z.Rasim Demiri, ministër për Zhvillim Rajonal, në mbledhje të Komisionit më 14.2.2018, lidhur me prioritetet e ministrisë;
7. Raportim i z.Faton Thaçi, zëvendësministër i Ministrisë së Tregtisë dhe

- Industrië, në mbledhje të Komisionit më 21.2.2018, lidhur me shqyrtimin në parim të Projektligjit nr.06/L-037 për Metrologji dhe Projektligjit nr.06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit;
8. Raportim i z.Faton Thaçi, zëvendësministër i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrië, në mbledhje të Komisionit më 27.2.2018, lidhur me shqyrtimin në parim të Projektligjit nr.06/L-040 për Masat Mbrojtëse në Importe;
  9. Raportim i z.Besnik Beka, zëvendësministër i Zhvillimit Ekonomik, në mbledhje të Komisionit më 27.2.2018, lidhur me Raportin e performancës së ndërmarrjeve publike, për vitin 2015 dhe 2016;
  10. Raportim i z. Valdrin Lluka, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, në mbledhje të Komisionit, më 19.3.2018, lidhur me gjendjen në: a) Shoqërinë Aksionare Trepça SH.A.; b) Ndërmarrjen Publike Posta e Kosovës SH.A.; dhe, c) Ndërmarrjen Publike Telekom i Kosovës SH.A.;
  11. Raportim i z.Fehmi Mujota, zëvendësministër i Ministrisë së Infrastrukturës, në mbledhje të Komisionit, më 16.5.2018, lidhur me shqyrtimin në parim të Pakos së projektligjeve të Ministrisë së Infrastrukturës për harmonizim me Ligjin për kundërvajtje;
  12. Raportim i z.Valdrin Lluka, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, në mbledhje të Komisionit, më 12.6.2018, lidhur me shqyrtimin në parim të Projektligjit nr.06/L-079 për Efiçencë të energjisë;
  13. Raportim i z.Faton Thaçi, zëvendësministër i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrië, në mbledhje të Komisionit më 26.6.2018, lidhur me shqyrtimin në parim të Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit “Konkurrenca e Ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (COSME) (2014-2020), 23.7.2018;
  14. Raportim z.Valdrin Lluka, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, në mbledhje të Komisionit, më 11.7.2018, lidhur me gjendjen në Ndërmarrjen Publike Telekom i Kosovës SH.A.;
  15. Raportim i z.Pal Lekaj, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës, në mbledhje të Komisionit, më 2.10.2018, lidhur me Projektligjin për Ratifikimin e Traktatit që themelon Komunitetin e Transportit;
  16. Raportim i z.Valdrin Lluka, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, në mbledhje të Komisionit, më 6.11.2018, lidhur me procesin e ndërtimit të Termocentralit Kosova e Re;
  17. Raportim i z.Endrit Shala, ministër i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrië, në mbledhje të Komisionit, më 20.11.2018, lidhur me punën e ministrisë për vitin 2018 dhe planifikimet për vitin e ardhshëm;
  18. Raportim i z.Bekim Jupa, zëvendësministër i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrië, në mbledhje të Komisionit, më 10.12.2018, lidhur me Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për Protokolin shtesë 5 të Marrëveshjes për Amendimin dhe Aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore;
  19. Raportim i z.Endrit Shala, ministër i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrië, në mbledhje të Komisionit, më 28.12.2018, lidhur me çmimet e naftës.

20. Raportim i z. Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik në mbledhje të Komisionit më 25.1.2019, lidhur me Shqyrtimin e Projekt-Statutit të Trepça SH.A.;
21. Raportim i z.Valdrin Lluka, ministër i Minitrisë së zhvillimit ekonomik, në mbledhje të Komisionit me datë 12.2.2019, lidhur me shqyrtimin e Raportit vjetor mbi Performancën e ndermarrjve publike për vitin 2017;
22. Raportim i z. Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik në mbledhje të Komisionit më 12.2.2019, lidhur me Vendimin e Qeverisë nr.05/85 datë 22.1.2019 me të cilin autorizohet Komisioni Qeveritar për Privatizimin e Ndërmarrjes Publike “Telekomi i Kosovës” SH.A”;
23. Raportim i z. Pal Lekaj, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe transportit, në mbledhje të Komisionit më 14.3.2019, lidhur me planifikimin e punëve dhe projekteve infrastrukturore për vitin 2019;
24. Raportim i znj. Magbule Shkodra, zëvendësministre e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal. në mbledhje të Komisionit më 2.4.2019, lidhur me ndarjen e granteve nga Ministria e zhvillimit rajonal, me theks të veçantë për bizneset e udhëhequra nga gratë;
25. Raportim i z. Pal Lekaj, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, në mbledhje të Komisionit më 19.6.2019. lidhur me monopolin në fushën e homologimit të veturave;

Në kuadër të trajtimit të çështjeve të caktuara në mbledhje të komisionit kanë raportuar apo kanë marrë pjesë në diskutim si më poshtë:

1. z. Arsim Janova, ushtrues detyre i kryesuesit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, në mbledhje të Komisionit më 14.3.2019, lidhur me shqetësimet e bizneseve për furnizimin me energji elektrike;
2. z. Arben Krasniqi, drejtor i Sekretariatit Koordinues të Qeverisë - ZKM, në mbledhje të Komisionit më 28.5.2019, lidhur me “Programin për zvogëlimin efektiv të barrës administrative në legjislacion dhe ekonomi;
3. znj.Ambasadorja Nataliya Apostolova, Shefe e Zyrës së BE-së në Kosovë/Përfaqësuese e Posaçme e BE-së në Kosovë, në mbledhje të Komisionit më 19.6.2019 për diskutim lidhur me monopolin në fushën e homologimit të veturave/barriera jo tarifore për importin e veturave të reja që kanë origjinën nga BE.

### **h) Dëgjimet publike**

Komisioni gjatë Legjislaturës VI ka konstatuar se dëgjimet publike janë në funksion të transparencës dhe të mbledhjes së informatave gjatë shqyrtimit të projektligjeve dhe të politikave të Qeverisë<sup>20</sup>. Komisioni i ka realizuar gjithsej 5 (pesë) dëgjime publike, prej tyre 3 (tri) dëgjime publike legjislative, dhe 2 (dy) dëgjime publike mbikëqyrëse.

Dëgjimet publike legjislative Komisioni i ka organizuar lidhur me projektligjet e veçanta

<sup>20</sup> Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 66.

dhe me specifikat e tyre që rregullojnë fushën e caktuar të një projektligji.

Siç u cek edhe me lart dëgjimet publike legislative janë mbajtur për projektligjet si vijon:

1. Projektligji për Miniera dhe Minerale (28.3.2018);
2. Projektligji për Mbrojtjen e Konsumatorit (4.4.2018);
3. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-132 për Automjete (18.7.2018);

Komisioni ka organizuar këto dëgjime publike mbikëqyrëse si vijon:

1. Dëgjim Publik për Mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Energjinë Elektrike (10.4.2019).
2. Dëgjim publik për Mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbime (29.5.2019).

Në këto dëgjime publike morën pjesë përfaqësues të Qeverisë, institucioneve publike, ndërmarrjeve publike, institucioneve të pavarura, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare të pranishme në Kosovë, odat ekonomike, bizneset, ekspertët, shoqëria civile dhe mediat.

#### **i. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve**

Komisioni kishte parasysh se një prej detyrimit kushtetues është edhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjit, e jo vetëm nxjerrja e tij. Për shkak se ligjet shpesh nuk zbatohen ashtu siç pritet ose synohet, qoftë për shkak të problemeve rreth zbatimit ose të ndryshimeve shoqërore dhe ekonomike, mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit është imperativ për një legjislativ efektiv.

Gjatë Legjislaturës VI Komisioni ka arritur që të bëjë mbikëqyrjen e zbatimit të 2 (dy) ligjeve<sup>21</sup>.

Komisioni ka mbikëqyrë zbatimin e ligjeve si në vijim:

1. Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Energjinë Elektrike, dhe
2. Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Shërbime.

Grupi punues për mbikëqyrje të zbatimit të Ligjit ka pasur autoritet të zhvillojë aktivitete të nevojshme, me qëllim që të mblidhen informata dhe të dhëna për zbatueshmërinë e ligjeve dhe në fund të përgatiste raport përmbledhës, të cilin do t'ia paraqiste Komisionit për shqyrtim.

Komisioni, arriti t'i përmyllte aktivitetet e planifikuara për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjeve. Gjatë kësaj periudhe, Komisioni ka bërë vizita në terren, janë mbajtur edhe takime të grupit punues, qëllimi i të cilave ishte koordinimi dhe planifikimi i aktiviteteve,

---

<sup>21</sup> Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 73.

si dhe ka ftuar në raportim përfaqësuesit e institucioneve përgjegjëse për zbatim të ligjeve në fjalë. Grupi punues ka organizuar dhe ka realizuar dëgjim publik për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, ku kanë prezantuar të ftuarit përfaqësuesit kompetent për zbatimin e ligjit. Pas çdo përfundimi të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, Komisioni ka miratuar raportin përmbledhës me rekomandime i cili iu është dërguar Kuvendit për miratim. Për shkak të shpërndarjes së Kuvendit, raportet për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve të përmendura më lart nuk janë shqyrtuar në seancë plenare.

#### **j. Aktivitetet e tjera në kuadër të fushëveprimit të Komisionit**

Anëtarë të Komisionit gjatë kësaj legjislature, morën pjesë nëpër tryeza dhe konferenca të organizuara nga organizata apo institucione të ndryshme, në të cilat u trajtuan tema të ndryshme nga fushe veprimtaria e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit ka marrë pjesë në Komisionin për përzgjedhjen e kandidatëve për Komisionin për Ndihmë Shtetërore.

#### **k. Vizita pune brenda vendit**

Më qëllim të shoh për së afërmi gjendjen dhe funksionimin e ministrive dhe autoriteteve rregullatorë që mbikëqyrë Komisioni gjatë kësaj legjislature ka bërë gjithsejtë 17 (shtatëmbëdhjetë) vizita brenda vendit.

Gjatë vitit 2017, Komisioni nuk ka realizuar vizita brenda vendit.

Gjatë vitit 2018, Komisioni i realizoi 6 (gjashtë) vizita brenda vendit, më qëllim që të shoh për së afërmi gjendjen në institucionet dhe subjektet, veprimtaria e të cilave ka të bëjë me fushëveprimin e Komisionit, si vijon:

- Vizitë në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, më 7.2.2018;
- Vizitë në Autoritetin e Aviacionit Civil, më 27.2.2018;
- Vizitë në KOSTT, në bashkëpunim me KDI-në, më 22.3.2018;
- Vizitë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, më 4.7.2018;
- Vizitë bizneseve prodhuese dhe tregtare në Ferizaj, më 9.11.2018;
- Vizitë ndërmarrjes publike KEK-ut, më 19.12.2018.

Gjatë vitit 2019, Komisioni i realizoi 11 (njëmbëdhjetë) vizita brenda vendit, më qëllim që të shoh për së afërmi gjendjen në institucionet dhe subjektet, veprimtaria e të cilave ka të bëjë me fushëveprimtarinë e Komisionit, si vijon:

- Vizitë në MTI - GP/Mbikëqyrja e Zbatimit të Ligjit për shërbime më 28.3.2019;
- Vizitë në MAP - GP/Mbikëqyrja e Zbatimit të Ligjit për shërbime 4.4.2019;
- Vizitë në MASHT - GP/Mbikëqyrja e Zbatimit të Ligjit për shërbime më 18.4.2019

- Vizitë në MD - GP/Mbikëqyrja e Zbatimit të Ligjit për shërbime më 18.4.2019;
- Vizitë në Komunën e Prishtinës – GP/Mbikëqyrja e Zbatimit të Ligjit për shërbime më 27.5.2019 2019;
- Vizitë në ARKEP më 17.6.2019;
- Vizitë në fabrikën e ujit KIKA më 3.7.2019;
- Vizitë në ndërmarrjen për prodhimin e energjisë me erë “Air Energy” më 3.7.2019;
- Vizitë në AAC më 18.7.2019;
- Vizitë në ASHNA më 18.7.2019;
- Vizitë në ANP më 18.7.2019.

### **l. Vizitat pune jashtë vendit**

Komisioni, në vazhden e punës së tij, e ka realizuar edhe anën e bashkëpunimit ndërkombëtar, duke marr pjesë në Konferenca rajonale dhe në seminare të Parlamentit Evropian, si dhe në punëtori të ndryshme etj., kështu që gjatë kësaj Legjislature Komisionit ka realizuar gjithsej 12 (dymbëdhjetë) vizita jashtë vendit, si vijon:

- Më 19-20 dhjetor 2017, në Plenumin e Komunitetit të Energjisë në Vjenë;
- Më 23-24 dhjetor 2017, në Punëtori në Durrës lidhur me funksionimin e agjencive të pavarura, organizuar nga OJQ Dplus;
- Më 12 mars 2018, me SECCP - Turqi;
- Më 24 prill 2018, në Plenumin Parlamentar të Komunitetit të Energjisë - Bruksel;
- Më 23-27 prill 2018, në Departamentin për Tregti – SHBA;
- Më 14 maj 2018, takim me kryetarët e Komisioneve Parlamentare për Energji – Bullgari;
- Më 7-8 qershor 2018, në vizitë studimore për Eficiencë të energjisë (GIZ) – Gjermani;
- Më 19-20 tetor 2018, vizitë në Vjenë Austri – EUFORES/GIZ;
- Më 27-28 nëntor 2018, vizitë në Shkup, Maqedoni, pjesëmarrje në Forumin për eficiencë të energjisë dhe klima, si dhe në Mbledhjen e Plenumit Parlamentar të Komunitetit të Energjisë;
- Më 3-5 dhjetor 2018, vizitë në Podgoricë, lidhur me eficiencën e energjisë – GIZ ORF EE.
- Më 19 shkurt 2019, Plenumi Parlamentar i Komunitetit të Energjisë - Bruksel;
- Më 8-9 maj 2019 në Kroaci – Grupi i punës për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjit për shërbime.

### **m. Takimet e Komisionit**

Gjatë ushtrimit të detyrave dhe të përgjegjësive në mënyrë më efikase Komisioni ka organizuar takime dhe e ka shtrirë bashkëpunimin me të gjitha subjektet, siç janë: Kryetari i Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, grupet parlamentare, komisionet parlamentare,



Zyra e Kryeministrit, ministritë përkatëse, institutet, pushteti lokal, përfaqësuesit e institucioneve të pavarura, përfaqësuesit e Odave ekonomike, me biznese, ambasadat, organizatat e shoqërisë civile, Organizatat ndërkombëtare në Kosovë, si dhe me sindikata të punëtoreve etj.

Gjatë Legjislaturës së VI Komisioni ka realizuar 40 (*katërdhjetë*) takime.

Gjatë vitit 2017, u realizuan 5 (pesë) takime si në vijim:

- Më 12.10.2017, kryetarja takim me INDEP;
- Më 23.10.2017 kryetarja takim me KDI;
- Më 12.12.2017 kryetarja takim me Shoqatën e Sigurimeve;
- Më 13.12.2017 Komisioni takim me Projektin e Binjakëzimit;
- Më 15.12.2017 Komisioni takim me drejtorin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Gjatë vitit 2018, u realizuan 26 (njëzet e gjashtë) takime si në vijim:

- Më 19.1.2018, takim i GP për Projektligjin për Shoqëritë Tregtare, me Odat ekonomike;
- Më 30.1.2018, takim i kryetares me përfaqësues të Ministrisë Federale të Gjermanisë;
- Më 2.2.2018, takim i Komisionit me përfaqësues të Departamentit për Tregti të SHBA-së;
- Më 16.2.2018, takim i kryetares me zv. ambasadoren e Kanadasë;
- Më 21.2.2018, takim i zv. kryetarit Dardan Sejdiu me ekspertë anglezë për konkurrencë;
- Më 27.2.2018, takim i kryetares me ekspertë holandezë, projekti për mbështetje Kuvendit;
- Më 6.3.2018, takim i kryetares me OJQ “Dplus”;
- Më 19.3.2018, takim i kryetares me OJQ “Lens”;
- Më 20.3.2018, takimi/pjesëmarrje e kryetares në Forumin e Lartë për Energji;
- Më 8.5.2018, takim i Komisionit me delegacionin nga Iowa;
- Më 8.5.2018, takim i Komisionit me përfaqësues të Bankës Botërore;
- Më 18.5.2018, takim i Komisionit me biznesmenë të diasporës;
- Më 28.5.2018, takim i Komisionit me Grupin e Miqësisë të Parlamentit Kroat;
- Më 13.6.2018, takim i kryetares me OJQ “Dplus”;
- Më 13.6.2018, takim i kryetares me Sindikatën e Trepçës;
- Më 26.6.2018, takim i Komisionit me CESS Projekti për mbështetje të Kuvendit;
- Më 7.9.2018, takim i kryetares me OJQ LENS;
- Më 7.9.2018, takim i kryetares me Sindikatën e KEDS-it;
- Më 5.10.2018, takim i kryetares me BDO-partnerin britanik;
- Më 16.10.2018 takim i kryetares me kompaninë Oberion Securities USA;
- Më 26.10.2018 takim i kryetares me Bordin e ZRRE;
- Më 29.10.2018 takim i kryetares me Klubin e prodhuesve kosovar;

- Më 26 dhe 29 tetor 2018 takim i Panelit për Bordin e KOSTT-it;
- Më 20.11.2018 takim i kryetares me BDO-partnerin britanik;
- Më 19.12.2018 takim i kryetares me BDO-partnerin britanik;
- Më 21.12.2018 takim i komisionit më Ministrin e tregtisë dhe Industrisë dhe odat ekonomike.

Gjatë vitit 2019, u realizuan 9 (nëntë) takime si në vijim:

- Më 10.1.2019 Kryetarja takim me Panelin e KOSTT-it;
- Më 10.1.2019 kryetarja takim me ministrin e zhvillimit ekonomik z. Valdrin Lluka;
- Më 14;15;16;17; dhe 18 janar 2019, 5 (pesë) Takime të Panelit për intervistimin e kandidatëve për Bordin e KOSTT-it;
- Më 5.2.2019 Kryetarja takim me DPLUS;
- Më 12.2.2019 Komisioni takim me J.Kopaç, SKE;
- Më 20.2.2019 Komisioni takim me MCC SHBA;
- Më 16.4.2019 Kryetarja takim me përfaqësues të KPMM-së;
- Më 31.5.2019 Komisioni takim me Oden Ekonomike Amerikane;
- Më 31.5.2019 Komisioni takim me Bankën Botërore/Prezenca në Kosovë.

#### **n. Tryeza/punëtori të organizuara**

Komisioni gjatë ushtrimit të detyrave dhe të përgjegjësive në mënyrë më efektive ka organizuar takime dhe e ka shtrirë bashkëpunimin me partneret e tij dhe ka konsideruar se tryezat e rumbullakëta ose konferencat janë mekanizëm i mirë për diskutime, propozime, mbledhjen e informatave, për legjislacionin që rregullon çështjet ekonomike dhe çështje të tjera të cilat prekin fushëveprimtarinë e Komisionit.

Në kuadër të këtij qëllimi Komisioni gjatë Legjislaturës VI, me mbështetjen edhe organizatave të tjera ka *organizuar 1 (një) punëtori, më 6-7 korrik 2018 në Prevallë, për shqyrtimin e projektstatutit të Trepçës.*

#### **o) Bashkëpunimi ndërparlamentar**

Komisioni ka zhvilluar edhe aktivitetin ndërkombëtar, duke qenë pjesë në dy organizata të rëndësishme, si në Plenumin Parlamentar të Komunitetit të Energjisë Vjenë/Austri. Si dhe SEECIP (Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore) – Sofje/Bullgari. Në të dy organizatat Komisioni është i përfaqësuar.

Gjatë kësaj legjislature, në kuadër të bashkëpunimit ndërparlamentar të grupeve të miqësisë, Komisioni më 28.5.2018 është takuar me Grupin e Miqësisë të Parlamentit Kroat.

#### **p) Buxheti i Komisionit**

Komisioni ka një buxhet prej 5.000 (pesëmijë) eurosh, në vit, i cili shfrytëzohet në bazë të Udhëzimit për administrimin e buxhetit të Komisioneve. Gjatë kësaj legjislature Komisioni ka shpenzuar pjesërisht buxhetin për shpenzime reprezentative në mbledhje dhe takime të Komisionit.

#### **IV. Rezyme e punës së Komisionit**

Komisioni gjatë kësaj legjislature në tërësi i ka realizuar aktivitetet e planifikuara në planet e tij të punës, ku ka shqyrtuar 72 (shtatëdhjetë e dy) lëndë dhe ka realizuar 190 (njëqind e nëntëdhjetë) aktivitete si mbledhje, dëgjime publike, grupe pune, vizita, takime, punëtori, etj., të paraqitura në shifra, si vijon:

- 22 Projektligje të shqyrtuara dhe miratuara në Komision,
- 3 Projektligje të proceduara për lexim dytë,
- 349 Amendamente të hartuara,
- 23 Vendime,
- 72 Mbledhje të rregullta,
- 17 Grupe pune të formuara,
- 40 Mbledhje të grupeve të punës,
- 5 Dëgjime Publike,
- 2 Monitorime të zbatimit të ligjit,
- 25 Raportime të ministrave apo zv. ministrave,
- 17 Raporteve të Agjencive të pavarura,
- 1 Tryeza/punëtori,
- 17 Vizita brenda vendit,
- 12 Vizita jashtë vendit,
- 40 Takime.

Të gjitha këto aktivitete janë bërë falë angazhimit të deputetëve, në veçanti, kryetares së komisionit, znj. Sala Berisha Shala. Në vijim është dhënë tabela e pjesëmarrjes së anëtarëve të Komisionit në aktivitete të Komisionit.

**Tabela: Angazhimi i deputetëve të Komisionit – Legjislatura VI**

<b>Nr. rendor</b>	<b>Emri dhe mbiemri i deputetit</b>	<b>Pjesëmarrje ne mbledhje</b>	<b>Kryesues grupi pune</b>	<b>Anëtarë grupi pune</b>
<b>1</b>	<b>SALA BERISHA SHALA</b> GP PDK	68	8	5
<b>2</b>	<b>DARDAN SEJDIU</b> GP PSD	52	6	5
<b>3</b>	<b>ADEM HOĐA</b> GP SL	26	/////	4
<b>4</b>	<b>HYKMETE BAJRAMI</b> GP LDK	58	4	6
<b>5</b>	<b>LUTFI ZHARKU</b> GP LDK	24	///	1
<b>6</b>	<b>GLAUK KONJUFCA</b> GP LVV	14	///	1
<b>7</b>	<b>LIBURN ALIU</b> GP LVV	19	///	5
<b>8</b>	<b>MEMLI KRASNIQI</b> GP PDK	41	///	2
<b>9</b>	<b>MUHARREM NITAJ</b> GP AAK	35	1	1
<b>10</b>	<b>VETON BERISHA</b> GP NISMA	31	/////	3
<b>11</b>	<b>DUDA BALJE</b> GP 6+	52	/////	4

Në vijim, në shifra më eksplicite në vitet përkatëse 2017, 2018 dhe 2019, janë të paraqitura në mënyrë tabelare të gjitha aktivitetet e Komisionit të realizuara gjatë Legjislaturës VI. Gjatë kësaj legjislature janë shqyrtuar shtatëdhjetë e dy (72) lëndë dhe ka realizuar njëqind e nëntëdhjetë (190) aktivitete

**Tabela: Pasqyra e përgjithshme e punës së Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal ne Legjislaturën e VI-të periudha 10 tetor 2017 – 23 korrik 2019.**

<b>Nr.</b>	<b>Indikatorët</b>	<b>2017</b>	<b>2018</b>	<b>2019</b>	<b>L-VI</b>
1.	Numri i mbledhjeve të mbajtura	10	44	18	<b>72</b>
2.	Numri i pikave të rendit të ditës	41	200	18	<b>315</b>
3.	Procesverbale të hartuara	10	44	18	<b>72</b>
4.	Projektligje të shqyrtuara	///	22	///	<b>22</b>
5.	Projektligje në procedurën e shqyrtimit në komision	2	1	///	<b>3</b>
6.	Numri i grupeve punuese të formuara	4	12	1	<b>17</b>
7.	Numri i mbledhjeve të grupeve punuese	5	29	6	<b>40</b>
8.	Numri i amendamenteve të shqyrtuara në cilësi të komisionit funksional	19	330	///	<b>349</b>
9.	Numri i raporteve për projektligje në cilësi të komisionit funksional	3	22	///	<b>25</b>
10.	Dhënia e mendimeve komisioneve të tjera	///	///	///	///
11.	Shqyrtimi i raporteve vjetore të institucioneve të pavarura	2	8	7	<b>17</b>
12.	Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike etj.	2	7	3	<b>12</b>
13.	Numri i vendimeve që i ka marrë komisioni	4	16	3	<b>23</b>
14.	Numri i raportimeve të ministrave	2	17	6	<b>25</b>
15.	Vizitat e realizuara jashtë vendit	2	8	2	<b>12</b>
16.	Vizitat e realizuara brenda vendit	///	6	11	<b>17</b>
17.	Dëgjime publike	///	3	2	<b>5</b>
18.	Monitorimi i ligjeve	///	///	2	<b>2</b>
19.	Rekomandime për emërimë në Institucionet e Pavarura	///	4	2	<b>6</b>
20.	Tryeza/Punëtori	///	1	///	<b>1</b>
21.	Projektligje të tërhequra nga Qeveria dhe të mos miratuara nga Kuvendi	///	3	///	<b>3</b>
22.	Numri i nismave legjislative	1	///	///	<b>1</b>
23.	Numri i Rekomandimeve	6	33	11	<b>50</b>
24.	Takime të Komisionit/kryetarit/anëtarëve	5	26	9	<b>40</b>

## V. Vlerësimi i Komisionit<sup>22</sup>

Në tërësi, puna e Komisionit ka qenë konform mandatit kushtetues dhe të Rregullores së Kuvendit.

Në pjesën legislative, Komisioni ka proceduar suksesshëm legjislacionin që ka ardhur në Kuvend. Komisioni nuk mund të fajësohet për ligjet të cilat janë vonuar të procedoheshin në Kuvend nga ana e Qeverisë. Komisioni ka shqyrtuar me shumë kujdes projektligjet duke bërë ndryshime dhe plotësime përmbajtjesore në funksion të përmirësimit të fushës që rregullon projektligji.

Edhe pse është bërë mjaft punë në kuadër të rolit mbikëqyrës, është pritur më shumë në pjesën e rolit mbikëqyrës dhe të gjithë përfshirjes. Në pjesën e rolit të mbikëqyrjes parlamentare ka pasur përparim të rëndësishëm. Thirrja në mënyrë periodike e ministrave për raportim në Komision ka qenë hap tejet pozitiv dhe ka vënë një standard të ri në punën e Komisionit. Edhe në pjesën e agjencive të pavarura ka pasur përparim të theksuar në inicimin dhe krijimin e mekanizmave të llogaridhënies që do të vlenin për të gjitha agjencitë dhe rregullatorët e tregut.

Gjithashtu vlen të theksohet se Komisioni është angazhuar edhe në vizita në terren te bizneset, te ndërmarrjet publike, si dhe institucionet tjera publike për të parë nga afër sfidat ligjore dhe funksionimin e tyre. Janë realizuar shumë takime të Komisionit, kryetares dhe anëtarëve të Komisionit me palë dhe institucione të ndryshme për të dëgjuar dhe shkëmbyer pikëpamjet lidhur me çështjet që bien në fushëveprimtarinë e Komisionit.

Gjatë gjithë kohës, Komisioni është mbështetur nga Njësia mbështetëse e Komisionit e cila ka ofruar këshilla dhe ka hartuar të gjitha dokumentet e nevojshme për punën e Komisionit. Njësia ka shpërndarë me kohë materialet e nevojshme për Komisionin dhe për të gjitha palët e interesit dhe ka njoftuar me kohë për agjendat e mbledhjeve dhe aktivitetëve të tjera. Kjo njësi ka bashkëpunuar ngushtë me shoqërinë civile dhe palët tjera të interesit dhe ka kontribuar ndjeshëm në sukseset e Komisionit.

*Raportin e përpiloi Njësia Mbështetëse e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri* <sup>23</sup>.

---

<sup>22</sup> Këtë pikë apo pikën “V. Vlerësimi i Komisionit” e ka bërë Instituti INDEP si monitorues dhe partner i Komisionit gjatë Legjislaturës V.

<sup>23</sup> Njësia mbështetëse e Komisionit ka këtë përbërje: Armend Ademaj, koordinatör i Komisionit, Muhamet Morina dhe Besim Haliti, zyrtarë të lartë të fushës, Veton Raci, zyrtar ligjor dhe Nurie Morina, nëpunëse administrative.